



INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE
Seria e Analizave Politike
ANALIZË POLITIKE #8

SERBËT PAS PAVARËSISË SË KOSOVËS -
MOMENTI I DUHUR PËR NDËRMARRJEN E
MASAVE TË MIRËBESIMIT

Prishtinë,
Korrik 2008
www.kipred.net

Ky projekt është përkrahur nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim, Kosovë

Përgatitur nga : Ilir Deda dhe Lulzim Peci, me ndihmë hulumtuese të Igor Artonoviç

Redaktuar nga: Ilir Dugolli

Copyright © 2008 KIPRED. Të gjitha të drejtat e riprodhimit janë të rezervuara. Përveç për mesimdhënie apo qëllime tjera jokomerciale, asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtrisëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar, etj., pa lejen me shkrim të autorit. Pjesë të shkurtra të tekstit, që nuk kalojnë dy paragrafë, mund të citohen pa lejen shprehimore të dhënë nga autori me kusht që të njihet burimi i plotë i tekstit. Luteni të kontaktoni: info@kipred.net apo +381 38 555 887.

Botuar nga



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave
Kodra e Diellit, Rruga 3, Lam. 39
Prishtinë, Kosovë (UNMIK)
Telefon dhe faks: +381 38 555 887
www.kipred.net

PËRMBAJTJA

I.	Hyrje.....	4
II.	Mjedisi i tanishëm politik brenda bashkësisë serbe në Kosovë	5
III.	Qëndrimet e udhëheqësisë politike të shqiptarëve të Kosovës.....	9
IV.	Rekomandime strategjike dhe të politikave	11

LISTA E SHKURTESAVE

KKK	Këshilli Konsultativ i Komuniteteve
DPKO	Departamenti për Operacione Paqeruajtëse
PDS	Partia Demokratike e Serbisë
IRJM	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
EULEX	Misioni Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë
ZCN	Zyra Civile Ndërkombëtare
PZH	Persona të Zhvendosur
GDN	Grupi Drejtues Ndërkombëtar
KFOR	Forca Ndërkombëtare për Kosovë
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale
MKK	Ministria për Kthim dhe Komunitete
MTT	Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit
MUP	Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë
ZÇK	Zyra për Çështje të Komuniteteve
PPL	Partia e Pavarur Liberale
KOS	Kisha Ortodokse Serbe
PRS	Partia Radikale Serbe
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

I. Hyrje

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, vendi ballafaqohet me një numër sfidash. Një nga çështjet më sfiduese paraqet trajtimi i komunitetit serb të Kosovës. Pavarësia e Kosovës ka ndikuar drejtpërsëdrejti tek shqiptarët dhe serbët si dhe në marrëdhëniet e tyre të brishta. Është mbresëlënësi fakti se përkundër parashikimeve ogurzeza që nga shpallja e pavarësisë nuk janë shënuar incidente serioze ndëretnike. Përkundër pritjeve, pavarësia ka zbutur nacionalizmin shqiptar duke krijuar moment të përshtatshëm për pranim të serbëve të Kosovës si pjesë përbërëse e shoqërisë. Serbët e Kosovës synojnë një jetë të denjë dhe të sigurt në Kosovë, por jetojnë në frikë nga shteti i ri dhe politikat e Beogradit. Gjithashtu, serbët janë duke kaluar nëpër një debat të heshtur brenda bashkësisë së tyre për të ardhmen e vet. I rëndësishëm është fakti se ata duken të jetë të përkushtuar të mbesin në Kosovë.

Autoritetet e Kosovës përmes Kushtetutës së re janë zotuar t'i respektojnë dhe zbatojnë standardet më të larta për mbrojtjen e bashkësive pakicë. Natyra e shtetit, ashtu siç është garantuar me Kushtetutë, mbështetet në përfshirjen e të gjitha bashkësive etnike dhe në simbolikë neutrale ndaj cilësdo bashkësi etnike të Kosovës, qasje kjo e cila është në kontrast me filozofinë e shteteve nacionale që mbizotëron në rajon. Shumica shqiptare e ka përqafuar një neutralitet të tillë dhe themelet qytetare të shtetit të ri. Kjo qasje i lë të hapura mundësitë për ndryshim thelbësor në marrëdhëniet shqiptaro-serbe. Në anën tjetër, pa bashkëpunimin e serbëve të Kosovës, dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës vështirë se mund të zbatohen në tërësi. Kjo do të kishte një ndikim negativ në jetën e serbëve të Kosovës si dhe në marrëdhëniet ndërmjet shumicës shqiptare dhe pakicës serbe.

Bashkësia serbe në Kosovë, posaçërisht në vendbanimet në jug të lumit Ibër ku jetojnë shumica e serbëve kosovarë, vazhdon të jetë në gjendje të ndjeshme, duke jetuar në frikë dhe e shtrënguar t'i nënshtrohet vullnetit të qeverisë së Serbisë. Një numër i udhëheqësve politik serbë në jug të Mitrovicës kundërshtojnë politikat e qeverisë së Serbisë, duke shprehur frikë që politikat e Beogradit mund të kenë për pasojë largimin e serbëve të Kosovës drejt Serbisë. Këta udhëheqës gjithashtu shprehin dyshimin e tyre se qëllimi përfundimtar i qeverisë së Serbisë është ndarja e Kosovës përgjatë lumit Ibër, gjë që do të nënkuptonte sakrifikimin e serbëve që jetojnë në pjesët tjera të Kosovës. Kjo frikë është shtuar pas themelimit të "Kuvendit të Komunave të Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë" nga Partia Demokratike e Serbisë (PDS) e ish-kryeministrit Vojislav Koshtunica dhe Partia Radikale e Serbisë (PRS) në Mitrovicë, të dala nga zgjedhjet e paligjshme komunale të 11 majit 2008. Frika e theksuar mund vetëm të rritet pas përkrahjes ruse të këtij hapi. Shumica e liderëve politik të serbëve të Kosovës, në një formë apo në një tjetër, e kanë kundërshtuar themelimin e këtij Kuvendi. Përkundër faktit që nga serbët e Kosovës nuk pritet t'a përqafojnë pavarësinë e Kosovës në të ardhmen e afërt, gjendja e përgjithshme është e qetë dhe me trend të zbutjes së mëtejme të marrëdhënieve ndëretnike. Serbët e Kosovës duhet të gëzojnë të drejtat të cilat u ofron Propozimi i Ahtisarit dhe zbatimi i planit nuk duhet të kushtëzohet. Pranimi i pavarësisë së Kosovës nga banorët serbë të vendit mund të ndodhë gjatë viteve në vijim, por derisa kjo të ndodhë duhet menduar për një *modus vivendi*.

Ky punim është i pari në serinë e punimeve të KIPRED-it që pritet të bëhet publike gjatë dy viteve të ardhshme. Nëpërmjet këtij punimi të shkurtër KIPRED synon të hulumtoj hapësirën e mundshme për masa të mirëbesimit, të cilat do të mund të zbatoheshin nga

autoritetet kosovare. Hulumentimi i hapësirës në fjalë kushtëzohet nga nevoja e shfrytëzimit të momentit të tanishëm për zhbërjen e frikës së serbëve të Kosovës nga ajo se çka sjellë pavarësia e Kosovës për ta, shmangien e pakënaqësisë së bashkësisë shumicë me mënyrën se si autoritetet trajtojnë çështjen e serbëve dhe parandalimin e shndërrimit të ndarjes në alternativën më të mundshme politike.

II. Mjedisi i tanishëm politik brenda bashkësisë serbe në Kosovë

Pas shpalljes të pavarësisë ravijëzohen tri grupe të ndryshme udhëheqësish në mesin e serbëve të Kosovës. Grupi i parë përfshin udhëheqësit politik të cilët bojkotuan institucionet e Kosovës, por në të njëjtën kohë kanë kundërshtuar politikat e Serbisë. Grupi i dytë përbëhet nga udhëheqësit dhe përkrahësit e partive politike të serbëve që marrin pjesë në institucionet e Kosovës. Grupi i tretë përfshin liderët politikë dhe të tjerë që kontrollohen drejtpërsëdrejti nga autoritetet e Beogradit. Këto ndarje janë shfaqur në masë të madhe përgjatë rrjedhës së lumit Ibër.

Rada Trajković është udhëheqësja e parë e serbëve të Kosovës që ka filluar publikisht të shprehë kritika kundër politikave të qeverisë së Beogradit karshi serbëve të Kosovës. Me vendbanim në Graçanicë, ajo për vite të tëra ka bërë përpjekje të nduarnduarta për ruajtjen e bashkësisë serbe në jug të Mitrovicës. Me djegien e pikave doganore në veriun e Kosovës me 19 shkurt 2008 dhe demonstratave në kufi nga rezervistë të ushtrisë serbe dhe studentë mitrovicas në javën e parë pas shpalljes së pavarësisë, Trajković aspërsoi kritikën kundër Koshtunicës dhe ministrit për Kosovë, Slobodan Samarxhiq. Në këtë mënyrë ajo është distancuar nga Beogradi duke shprehur një qasje ndryshe të serbëve të Kosovës në orvatjet për mbrojtur interesat e serbëve në enklava.

Këtij mospajtimi i ishte bashkuar një zë tjetër i ngjashëm – ai i udhëheqësit politik të serbëve nga veriu i Mitrovicës, Oliver Ivanović. Ky është përpjekur të zhvilloj politika alternative ndaj liderëve të PDS-it nga Mitrovica veriore, si Marko Jakshiq dhe Milan Ivanović¹, udhëheqës këta që janë forcuar edhe më tepër në maj të vitit 2008². Pavarësisht përpjekjeve si ato të Ivanovićit, veriu i Kosovës kryesisht mbetet peng i një numri të udhëheqësve lokal të përkrahur nga strukturat qeveritare të Beogradit. Për pasojë, gjendja në fjalë i ka shuar zërat e udhëheqësve të komunave të veriut që më parë kishin shfaqur një gatishmëri të kujdesshme për bashkëpunim me autoritetet e Prishtinës.

Pas shpalljes së pavarësisë, serbët e Kosovës me përkrahjen dhe tryshninë e Qeverisë së Serbisë kanë inskenuar bojkot pothuajse të plotë ndaj institucioneve të Kosovës, si Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK), sistemit gjyqësor, administratës komunale, Doganës së Kosovës, Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Hekurudhave të Kosovës. Te frikësuar nga ministri i Qeverisë së kryeministrit Koshtunica dhe pjesëtarëve të shërbimit sekret të Serbisë, serbët e Kosovës në jug të lumit Ibër u gjendën të ngulfatur në lojalitetin e verbër

¹ Një numër i zyrtarëve ndërkombëtarë në Prishtinë i kanë konfirmuar KIPRED-it se një ndarje e madhe e financave të PDS-së vjen nga grupet e kontrolluara nga Marko Jakshiq.

² Liderët në pyetje e kanë forcuar pozicionin e tyre nëpërmjet zgjedhjeve lokale të Serbisë të mbajtura në Kosovë me 11 maj 2008.

ndaj Qeverisë së Serbisë, për shkak të vartësisë financiare dhe gjasave për një jetë të dinjitetshme në Kosovë.

Pjesa veriore e Kosovës vazhdon të jetë pothuajse pa pushtet, që nga demonstratat e dhunshme të 17 marsit 2008, ku pas uzurpimit të Gjykatës së Qarkut nga gjykatës dhe prokurorë serbë të përkrahur nga pjesëtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MUP), policia e UNMIK-ut dhe KFOR-i u përpoqën ta kthejnë atë nën kontroll. Shkatërrimi i pikave doganore në pjesën e kufirit të Kosovës me Serbinë ka krijuar terren të frytshëm për kontrabandë masive, paligjshmëri dhe lulëzim të krimin të organizuar. Për ironi, ekstremistët serbë nuk i shkatërruan pikat doganore dhe kufitare në anën serbe të kufirit, duke njohur në thelb vijën kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ironia bëhet edhe më e madhe me dështimin e pranisë ndërkombëtare në Kosovë për të rivendosur regjimin kufitar në këto vendkalime, duke i dhënë kështu një nxitje më shumë anarkisë në veri.

Bojkoti i institucioneve nga ana e serbëve nuk ka qenë i njëtrajtshëm në mbarë Kosovën. Përderisa nëpunësit civil serbë kanë zgjedhur të largohen nga vendet e tyre të punës në komunat ku ata përbëjnë shumicën ose një pjesë të madhe të popullsisë³, ata vazhdojnë të kryejnë punët e tyre në komunat ku janë pakicë⁴. Serbët e Kosovës gjithashtu vazhdojnë të punojnë në SHPK në veriun e vendit, ku policia e UNMIK-ut ushtron komandë të drejtpërdrejt operacionale të strukturave policore. Megjithatë, të njëjtit i kanë acaruar marrëdhëniet me komandën qendrore të SHPK-së dhe kanë nënshkruar kontrata me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë (MUP). Ata në një masë bojkotojnë SHPK-në në pjesën qendrore dhe lindore të Kosovës, ndërsa përgjithësisht marrin pjesë në strukturat e policisë në pjesën jugore (Shtërpçë). Një numër i nëpunësve civil serbë të Kosovës pa bujë të madhe u janë kthyer vendeve të tyre të punës, përfshirë këtu edhe pjesëtarë të SHPK-së. Ministri i Kosovës për Punë të Brendshme (MPB) Zenun Pajaziti ka demonstruar gatishmëri të shkëlqyeshme politike dhe vullnet të mirë kur ka vendosur të vazhdojë suspendimin me pagesë të anëtarëve të SHPK-së në fund të majit të vitit 2008, duke lënë derën e hapur për kthimin eventual të tyre dhe ruajtjen e karakterit shumë-etnik të SHPK-së.

Në nivelin qendror, udhëheqësit e ministrive nga radhët e Partisë së Pavarur Liberale (PPL) Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministri për Komunitete dhe Kthim janë aktivisht të angazhuar në punën e tyre si pjesë e Qeverisë. E njëjta vlen edhe për kolegët e tyre deputetë në Kuvendin e Kosovës. Ministrat e PPL-së kanë qenë të dobishëm në mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të bashkësisë serbe. Pavarësisht sfidave të shumta me të cilat ballafaqohen ata, vendosmëria dhe angazhimi i tyre i gërshetuar me disa të arritura konkrete fillestare duket të ketë shtuar besimin e serbëve në PPL.

Liderët e PPL-së janë treguar të dobishëm në shprehjen dhe realizimin e kërkesave të banorëve serbë në qendër të Kosovës karshi Qeverisë së Kosovës, si b.f. gjetja e zgjidhjeve konkrete në bashkëpunim me Ministrin e Transportit dhe Telekomunikacionit (MTT), Fatmir Limaj, për planifikimin e ndërtimit të rrugëve që kalojnë në fshatrat serbe (p.sh. Çagllavicë dhe Llapnasellë). Ministria e Kthimit dhe Komuniteteve (MKK) ka marrë në duar

³ Shtërpçë, Kamenicë, Novobërdë dhe Gjilan.

⁴ Fushë Kosovë, Lipjan dhe vende tjera.

të veta buxhetin deri më tani të kontrolluar nga UNDP, dhe është gati të vazhdoj gjatë vitit 2008 jetësimin e tri projekteve madhore për kthim⁵. Ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale (MPQS), Nenad Rashiç ka arritur të tejkaloj vështirësitë fillestare në punë dhe të merret me projekte në të mirë të të gjithë kosovarëve.

Zgjedhjet lokale të organizuara nga Republika e Serbisë në Kosovë me 11 maj 2008, të cilësuar si të paligjshme nga UNMIK-u, Grupi Drejtues Ndërkombëtarë (GDN), Zyra Civile Ndërkombëtare (ZCN) dhe Qeveria e Kosovës, vetëm sa e kanë bërë edhe më të ndërlikuar gjendjen e serbëve në vend. Duke bërë veshin e shurdhër ndaj zgjedhjeve në territorin e Kosovës u është vështirësuar jeta udhëheqëseve të moderuar serb. Zgjedhjet u fituan nga Partia Radikale Serbe (PRS) dhe Partia Demokratike e Serbisë (PDS). Megjithatë, vetëm 46% e serbëve morën pjesë në zgjedhje, duke përfshirë këtu edhe personat e zhvendosur. Pjesëmarrja në zgjedhje ishte më e madhe në veriun e Kosovës në krahasim me enklava⁶. Kjo tregon zhgënjimin e serbëve të Kosovës në jug të lumit Ibër me politikën e Beogradit dhe njëkohësisht hap një shteg mundësisë që udhëheqësit e moderuar serb në njërin anë dhe Qeveria e Kosovës në anën tjetër të angazhohen pozitivisht për bashkëpunim të ndërsjellë.

Pavarësisht mundësisë së lartpërmendur janë shfaqur ndërlikime shtesë kur Organizata e Kombeve të Bashkuara, gjegjësisht Departamenti i Operacioneve Paqeruajtëse (DPKO)⁷, nuk e lejoi PSSP-në Joakim Ryker që t'ua vazhdoj mandatin kryetarëve të komunave dhe kuvendeve (vazhdimi i mandatit për kryetarë dhe kuvendet komunale në Leposaviq, Zveqan, Zubin Potok, Shtërpçë dhe vazhdimi i mandatit të kuvendit komunal në Novobërdë, ku një kandidat shqiptar u zgjodh për kryetar të komunës në zgjedhjet e 17 nëntorit të vitit 2007)⁸.

Në anën tjetër, zgjedhjet e 11 majit u shpallën të paligjshme nga UNMIK-u⁹. Në thelb përveç deklaratave të të gjitha institucioneve relevante ndërkombëtare dhe vendore, nuk ka pasur ndonjë veprim konkret në parandalimin që strukturat paralele të konstituohen dhe të uzurpojnë institucionet komunale. Deri më tani i vetmi entitet që vepron në mënyrë të vazhdueshme në zbatimin e politikave të saj është Republika e Serbisë, duke e bërë kështu të kuptueshëm suksesin relativ të saj. Kjo gjendje e paqartësisë i mbanë pezull zyrtarët e

⁵ Qeveria e Kosovës në vitin 2004 i dha UNDP-së nën mbikëqyrje buxhetin për kthim . Kjo ka kthyer tensione kur ministria është formuar në fund të vitit të njëjtë, pasi që ministrat nga radhët e bashkësisë serbe ndjeheshin të pafuqishëm për të kryer punë pa buxhet.

⁶ Për detaje shih: Rezultati i zborit për odbornike skopstina opština na teritoriji Autonomne Pokrajine Kosovo i Metohija (Rezultatet e zgjedhjeve për delegatët e komunave në territorin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë), Komisioni Republikani i Zgjedhjeve të Serbisë, në: http://www.rik.parlament.sr.gov.yu/cirilica/propisi_frames.htm

⁷ A po i pranon kreu i OKB-se zgjedhjet lokale serbe te organizuara ne Kosove me 11 Maj? “Zëri”, faqe 3, 19 qershor 2008.

⁸ Në dhjetor të vitit 2007, pas bojkotit të serbëve të Kosovës të zgjedhjeve të përgjithshme, komunale dhe të kryetarëve të komunave, PSSP-ja Joachim Ruecker përdori autoritetin e tij ekzekutiv bazuar në Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të KB 1244 që të vazhdoj përkohësisht mandatin e zyrtarëve serbë të zgjedhur në vitin 2002 për gjashtë muaj në katër nga pesë komuna ku serbët përbëjnë shumicën, deri më 11 maj 2008. Në Novobërdë, Ruecker lejoi kryetarin shqiptarë të zgjedhur të marrë zyrën, derisa shumica e anëtarëve të kuvendit të komunës ishin delegatë serb nga Kosova.

⁹ Shih komunikatën për shtyp të PSSP-së “ Deklaratë lidhur me Zgjedhjet lokale të Serbisë të mbajtura sot në Kosovë”, 11 maj 2008, UNMIK/PR/1732

ligjshëm dhe përmban elemente të marrjes së paligjshme të pushtetit. Për më tepër, në pesë komuna të Kosovës zyrtarët e “zgjedhur” më 11 maj, ngadalë kanë filluar të ushtrojnë pushtetin e tyre politik. Kjo, ka gjasë t’i forcoj bindjen e një pjese të serbëve të Kosovës, posaçërisht në komunat e veriut, se jeta dhe zhvillimi nëpërmjet strukturave paralele është i mundshëm. KIPRED vazhdimisht ka hasur në sjellje të ndryshme në veri, krahasuar me qëndrimet në jug të Mitrovicës. Megjithatë, mosveprimi i institucioneve ndërkombëtare dhe vendore në Kosovë dhe aktivitetet e Serbisë kanë bërë që në komunën e Shtërpçës të shfaqet potencial i lartë i përkeqësimit, duke krijuar dy pika neuralgjike të eskalimit të mundshëm: një në veri (Mitrovicë) dhe tjetra në jug (Shtërpçë). Kjo është një sfidë me të cilën Kosova nuk është ballafaquar deri me tani.

Bashkësia serbe dhe përfaqësuesit politik, përfshi një numër të “zgjedhurve” më 11 maj, janë të vetëdijshëm që organizimi i institucioneve paralele nuk do të ketë sukses në jug¹⁰. Kështu, krijimi i “Kuvendit të Komunave të Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë” me 28 qershor 2008 pritet të ketë ndonjë ndikim vetëm në pjesën veriore të Kosovës. Ky kuvend, i cili është themeluar kryesisht nga anëtarët e PRS dhe PDS, pritet t’u shërbejë dy qëllimeve: fuqizimit të ndarjes funksionale të serbëve të Kosovës, mbështetur në strategjinë e Koshtunicës dhe të shërbej si mjet politik për pengimin e çfarëdo ndryshimi të mundshëm të politikave të Beogradit karshi Kosovës nga qeveria e Tadiqit. Kjo lëvizje politike mund të fitoj në peshë nëse ndarja e Kosovës brenda qarqeve ndërkombëtare shndërrohet në opsion politik, zgjidhje kjo tanimë e nxitur nga Rusia dhe një numër i shteteve të BE-së¹¹.

Ndarja në spektrin politik serb ka prekur gjithashtu edhe Kishën Ortodokse Serbe (KOS). Menjëherë pas 17 shkurtit, peshkopi i KOS-it Artemije ua ndaloj anëtarëve të Kishës të komunikojnë në çfarëdo forme më autoritetet e Kosovës dhe përfaqësues të vendeve që kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Me 4 mars 2008 Sinodi i Shenjtë i KOS-it mbajti takim të rregullt në Patrikanën e Pejës dhe vizitoi objektet e rindërtuara, të shkatërruar gjatë demonstratave të marsit 2004. Kryesuesi i Sinodit, Arqipeshkvi Amfilohije shprehu vlerësimin e Sinodit për angazhimet në rindërtimin e Kishave dhe manastireve të dëmtuara, dhe nxiti anëtarët e KOS-it të vazhdojnë komunikimin me qeverinë e Kosovës dhe të gjithë përfaqësuesit ndërkombëtarë “pa të cilët mbijetesa e njerëzve tanë dhe vendeve tona të shenjta nuk do të ishte e mundur”¹². Kjo nxiti një debat publik ndërmjet peshkopit dhe Arqipeshkvit, e cila gjithashtu pasqyron deri në një masë debatet e brendshme brenda bashkësisë serbe në Kosovë.

Serbët që jetojnë në pjesën qendrore dhe jugore të Kosovës, ndihen të marginalizuar, të harruar dhe të lënë anash. Ata ndjehen të izoluar nga politikat e veriut të cilat nuk pasqyrojnë gjendjen reale të serbëve në jug, përkundër faktit se shumica e serbëve të Kosovës jetojnë në jug të Mitrovicës. Kjo ka ndikuar edhe më shumë në pasigurinë e tyre për të ardhmen duke i lënë ata me “valixhe të gatshme” si pasojë e kërcënimit të përhershëm nga ndarja. Në fakt, serbët e jugut të Mitrovicës janë kundërshtarët më të fortë të një ndarjeje të tillë. Ky kundërshtim është forcuar gjatë nëntë viteve të fundit nga mos përfillja e tyre në prioritetet e ndjekura në pjesën veriore të Mitrovicës për sa i përket politikave të donatorëve dhe

¹⁰ Intervista të KIPRED me lider të komuniteteve, 24 qershor 2008.

¹¹ Intervistë e KIPRED me diplomat të BE-së në Prishtinë, qershor 2008

¹² Amfilohije: Odrzati komunikaciju (Mbajtja e komunikimit) 4 mars 2008,

http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2008&mm=03&dd=04&nav_category=640&nav_id=287692

prioriteteve politike të bashkësisë ndërkombëtar, Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë. Për dallim nga ata serbë të cilët jetojnë në mjedis etnikisht të pastër, serbët e tjerë në Kosovë tregohen më të gatshëm të bashkëpunojnë me Prishtinën, në pritje të masave konkrete të vullnetit të mirë të ofruara nga Qeveria e Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare¹³. Mirëpo, këto masa nuk duhet kurrsesi të kushtëzohen politikisht. Serbët e Kosovës janë në një proces të mosnjohjes formale të pavarësisë së Kosovës në të njëjtën kohë që ata kanë respekt për ligjin në Kosovë, duke parë kështu procesin e decentralizimit si element qenësor që siguron të ardhmen e tyre në Kosovë¹⁴. Është me rëndësi që udhëheqësia e Kosovës të jetë e kujdeseshme dhe të tregoj transparencë dhe mirëkuptim për këtë zhvillim politik.

III. Qëndrimet e udhëheqësisë politike të Kosovës

Në Deklaratën e Pavarësisë, ndër të tjera, theksohet se Kosova i pranon plotësisht detyrimet nga Propozimi Gjithëpërfshirës për Statusin e Kosovës. Ky plan përmban standardet më të larta për mbrojtjen e bashkësive, kryesisht për serbët e Kosovës, përmes decentralizimit, krijimit të komunave të reja ku serbët përbëjnë shumicë, policisë lokale dhe gjyqësisë, sistemit shëndetësor, arsimit ekonomisë lokale, ndihmës financiare dhe njerëzore nga Serbia si dhe aspekteve të tjera. Dispozitat e planit janë bërë pjesë integrale e kornizës ligjore dhe te institucioneve të Kosovës.

Përkundër provokimeve të vazhdueshme të Serbisë drejt ndezjes së dhunës ndëretnike në Kosovë, e tërë klasa politike e Kosovës ka treguar maturi dhe vëmendje të lartë për menaxhimin paqësor të gjendjes së krijuar. Autoritetet e Kosovës, posaçërisht Kryeministri Hashim Thaçi, kanë treguar lidërsip të fuqishëm me mesazhe pozitive, gjë që ka ulur ndjenjat armiqësore ndaj komunitetit serb para, gjatë dhe menjëherë pas shpalljes së pavarësisë. Për më tepër, udhëheqësia kosovare, përkundër problemeve serioze brenda partive politike në pushtet dhe opozitës ka treguar përkushtim të jashtëzakonshëm ndaj pranimin dhe përkrahjes së natyrës multi-etnike të shtetit të Kosovës, gjë që është ilustruar edhe në rastin e zgjedhjeve të simboleve shtetërore si flamuri, himni shtetëror, mandej Kushtetuta e Kosovës dhe 41 ligjet e Propozimit të Ahtisarit.

Sidoqoftë, në muajt e fundit, Kryeministri nuk e ka vazhduar më të njëjtën shkallë të lidërsipit të demonstruar më herët, gjë që ka bërë serbët të dyshojnë në përkushtimin e tij të plotë ndaj integritetit dhe përfshirjes së tyre në shoqërinë kosovare. Për më tepër, angazhimi i tij personal në këtë çështje nuk ka arritur të shtrihet tërësisht brenda Qeverisë, duke mbetur kështu më tepër një politikë e tij personale sesa një politikë e mbarë Qeverisë. Në shumë raste qeveria ka dështuar të përgatisë materiale zyrtare në të dy gjuhët zyrtare (në atë shqipë dhe serbe). Po ashtu, institucionet e reja shtetërore siç janë policia, gjyqësia dhe shëndetësia ende nuk e respektojnë politikën për përdorimin e dy gjuhëve në komunikimin zyrtarë, gjë që janë të obliguar ta bëjnë sipas Kushtetutës dhe Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve¹⁵.

¹³ Kjo sjellje i është konfirmuar KIPRED-it nga pothuajse të gjithë udhëheqësit politik të komunitetit serb në pjesën qendrore dhe jugore të Kosovës, përgjatë prillit, majit dhe qershorit të vitit 2008.

¹⁴ Intervista të KIPRED-it me 20 prill, 28 maj, 24 qershor 2008.

¹⁵ KIPREDI-t i janë prezantuar dokumente të dorëzuara nga autoritetet kosovare të cilat dëshmojnë për dështimin për të plotësuar kërkesat ligjore për përdorimin e gjuhëve. Maj/qershor 2008.

Në anën tjetër, presidenti Fatmir Sejdiu ka treguar indiferencë për sa i përket udhëheqjes së shtetit si president i të gjithë qytetarëve¹⁶. Ai po ashtu, përkundër disa takimeve të bëra me përfaqësues të komuniteteve, nuk ka arritur ende ta themeloj Këshillin Konsultativ të Komuniteteve, organ ky që parashihet me Kushtetutën e Kosovës

Të vetmen strategji që e kanë institucionet e Kosovës për përfshirjen e serbëve të Kosovës është implementimi i decentralizimit, ashtu siç parashihet në Propozimin e Ahtisarit. Zbatimi i suksesshëm i decentralizimit dhe akomodimi i serbëve të Kosovës nuk mund të bëhet pa masa mirëbesimi. Për më tepër, është e rëndësishme thelbësore të kuptohet se karakteri shumë-etnik i Kosovës mund të ruhet dhe mbrohet vetëm duke nxitur dhe treguar përkushtim ndaj përfshirjes së serbëve të Kosovës në jug të Ibrit, hapësirë kjo ku shumë-etniciteti është fakt. Arritja e shumë-etnicitetit gjithëpërfshirës në jug të lumit Ibër do të jetë i vetmi mjet i suksesshëm i integritetit të veriut dhe garanton vendit shmangien e ndarjes, gjë kjo që ende nuk përkrahet sa duhet nga udhëheqësia e vendit dhe udhëheqësit e serbëve si në jug ashtu edhe në veri.

IV. Rekomandime strategjike dhe të politikave

Koha po ecën shpejt dhe Kosova nuk e ka luksin për të përcjell në mënyrë pasive zhvillimet ndërkombëtare ndaj rajonit dhe Kosovës. Autoritetet e Kosovës duhet të marrin në konsideratë se realiteti në vend mund të evoluojë në gjendje të ndryshme politike, gjegjësisht të qoj drejt zhvleftësimit e pakos së Ahtisarit, krijimin e “konfliktit të ngrirë” apo hyrjen në një fazë të re të riaranzhimit me veriun. Zhvleftësimi i Propozimit të Ahtisarit nënkupton shkatërrimin e funksionalitetit të shtetit të Kosovës.

Në frymën e asaj që u tha më lartë, KIPRED-i në vijim propozon rekomandime strategjike dhe politike, të cilat do të duhej filluar së zbatuari jo më vonë se në shtator 2008.

Autoritetet e Kosovës - duhet vazhdimisht ta bëjnë të qartë, përmes deklaratave dhe veprimeve politike, se serbët e Kosovës janë pjesë integrale e shoqërisë, se Kosova u takon të gjithë qytetarëve të saj dhe se e ardhmja e tyre është në Kosovë. Për më tepër, autoritetet e Kosovës nuk duhet të ndërhyjnë në debatet e brendshme të serbëve të Kosovës. Në fakt, ata duhet të përmbahen maksimalisht nga përdorimi i publicitetit medial për çfarëdo mase të ndërtimit të mirëbesimit derisa të bëhen ndryshime përmbajtësore në vend. Autoritetet në Prishtinë duhet po ashtu të demonstrojnë respektim të politikës për përdorimin e dy gjuhëve në komunikimin zyrtarë, brenda qeverisë kur komunikojnë me ministrat serbë, si dhe me qytetarët e bashkësisë serbe.

Presidenti i Kosovës - duhet vazhdimisht dhe fuqimisht të përfaqësoj unitetin e të gjithë banorëve të Kosovës, si dhe të përshtatë retorikën me veprimet e tij. Përveç kësaj, Presidenti duhet të themeloj urgjentisht Këshillin Konsultativ të Komuniteteve (KKK) dhe t'i jap kuptim domethënës këtij trupi në ndërtimin e Kosovës mbi themele shumë-etnike.

Kryeministri i Kosovës - duhet të manifestoje liderhipin sikur gjatë pavarësisë, dhe ta zgjerojë atë nga një politikë personale në politikë qeveritare. Gjithashtu, Kryeministrit duhet

¹⁶ Udhëheqësit e serbëve të Kosovës, duke përfshirë anëtarët e qeverisë janë ankuar se Presidenti nuk po përdorë gjuhë pozitive karshi bashkësisë serbe. Intervista të KIPRED-it, maj/qershor 2008.

të themelohet menjëherë Zyrën për Çështje të Komuniteteve (ZÇK) brenda Zyrës së Kryeministrit, në konsultim dhe koordinim me Ministrinë për Kthim dhe Komunitete si dhe me lidërshtipin e PPL, në mënyrë që të siguroj përfshirje të plotë të komunitetit serb në përmirësimin e jetës së tyre në Kosovë.

Kuvendi i Kosovës - duhet të konsideroj fuqimisht rishpalljen e kriterëve të përshtatura të përzgjedhjes për Ombudperson dhe zëvendësin e tij. Kuvendi duhet të këtë parasysh praktikën e mira nga IRJM ku Ombudpersoni është gjithmonë anëtarë i bashkësisë shqiptare, dhe ku zëvendësi i tij vjen nga radhët e bashkësisë shumicë. Ky veprim mund të jetë domethënë në forcimin e besimit të serbëve të Kosovës në institucionet e Kosovës.

Ministria e Punëve të Brendshme dhe Shërbimi Policor i Kosovës – duhet të marrin masa shtesë për të garantuar sigurinë e vendbanimeve serbe në jug të lumit Ibër, dhe të gjej zgjidhje për pjesëtarët serb të SHPK-së, duke punuar drejt kthimit të pjesëtarëve të suspenduar apo duke filluar me rekrutim të zyrtarëve të ri policor Serb deri në tetor 2008.

Lidërshtipi i Partisë së Pavarur Liberale (PPL)- duhet të ndihmoj dhe të udhëheq bashkëpunimin me lidërshtipë të tjerë të moderuar të serbëve të Kosovës në debatin mbi decentralizimin brenda komunitetit serb.

Qeveria e Kosovës – duhet të zhvilloj **strategji për forcimin e marrëdhënieve** të serbëve të Kosovës në Kosovën qendrore dhe jugore si orientim politik për përfshirjen afatgjatë të bashkësisë serbe në Kosovë. Prandaj, duhet menduar për krijim të një organi ndër-qeveritar nën udhëheqësinë e Kryeministrit, e të përbërë prej anëtarëve nga: Ministria për Komuniteteve dhe Kthimit, Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Gjithashtu, duhet bërë gjithë çfarë është e mundur për alokim të buxhetit të mjaftueshëm në mënyrë që të planifikohen dhe zbatohen pa kushte veprimet e mëposhtme:

- Të përmirësohet dhe të ndërtohet infrastruktura publike (rrugët, shkollat, objekte shëndetësore, objekte për rini dhe edukim, ujë, kanalizime etj), në bashkëpunim me udhëheqësit e bashkësisë serbe në Kosovën qendrore dhe jugore si dhe të ketë përkujdesje që këto punë udhëhiqet nga kërkesa. Në vendbanimet shumë-etnike të përdoren projektet e barabarta nga të cilat përfitojnë të gjitha komunitetet;
- Të respektohet në mënyrë rigorozë ndarja e barabartë e buxhetit në nivele komunale, ashtu siç parashihet me ligj;
- Të fillohet me zbatimin e këtyre projekteve njëkohësisht në tërë vendbanimet serbe në jug të Ibrit;
- Të ndërtohen objekte të shëndetësisë sekondare në qendër të Kosovës, me pajtim paraprak të komunitetit serb për menaxhimin e këtyre objekteve të cilat do të vepronin nën kornizën ligjore të Kosovës;
- Ndërtimi i degëve të Universitetit Publik të Mitrovicës në qendër të Kosovës;
- Të fillohet me ndërtimin e objekteve për komunat e reja, siç janë paraparë me dispozitat për decentralizimin në Propozimin e Ahtisarit. Në këtë mënyrë, do të demonstrohej serioziteti i autoriteteve të Kosovës në zbatimin e decentralizimit;

- Ministria e Bujqësisë duhet të zhvilloj një strategji për zhvillimin bujqësor dhe të industrisë së ushqimit, me fokus të veçantë në vendbanimet shumë-etnike;
- Të rindërtohen dhe mirëmbahen si duhet varrezat e shkatërruara të serbëve të Kosovës;
- Të vazhdohet me rindërtimin e suksesshëm të kishave dhe manastireve të rrënuara apo dëmtuara;
- Të tregohet ndjeshmëri maksimale ndaj çështjeve humanitare, siç është furnizimi me barna dhe transport mjekësor;
- T'u besohet rindërtimi (me përjashtim të objekteve fetare) organizatave vendore për zhvillim të komuniteteve (shqiptarë të Kosovës dhe serb të Kosovës), gjë që do të ngrite ndjenjën e pronësisë dhe do të përmirësonte perceptimet ekzistuese pronësinë vendore dhe përmirësoj perceptimet ekzistuese;
- PPL duhet të punoj ngushtë me komunitetin serb në mënyrë që të parandaloj abuzimin politik të investimeve të infrastrukturës publike, për shembull të sigurohet që objektet publike nuk do të merren përsipër nga strukturat paralele.

Komuniteti i donatorëve- në pajtim me këtë strategji duhet të përkrah Qeverinë e Kosovës në zbatimin e strategjisë për forcimin e serbëve të Kosovës në jug të Ibrit dhe të vazhdoj me punën e vet në veri, si dhe të ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

- Të zhvilloj dhe mbështesë projektet e caktuara për zhvillimin e komuniteteve, për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;
- Të forcoj aspektet socio-ekonomike në vendbanimet serbe në jug të Ibrit, dhe të nxisë dhe ndihmoj investimet private, mes tjerash përmes kredive të vogla;
- Të përkrahët ndërtimi i lagjeve urbane mes Llapnasellës dhe Graçanicës;
- Të mos vazhdoj me planet për ndërtimin e Universitetit Ndërkombëtarë në Mitrovicë. Në vend të kësaj të konsiderohet krijimi i objekteve për Universitet Evropian në qendër të Kosovës, me qasje të lirë për të gjitha komunitetet e Kosovës;
- Ambasada e SHBA-ve dhe Mbretërisë së Bashkuar duhet të fillojnë me organizimin e kurseve të gjuhës angleze për rininë e serbëve të Kosovës në tërë Kosovën;
- BE duhet të prezantoj program të njëjtë si ai i “skemës për trajnimin e të rinjve”¹⁷ i cili do të ketë për cak komunitetet, dhe në veçanti komunitetin serb;
- Të ndajë fonde të nevojshme për pranimin e së paku 20 serbëve të Kosovës në vit në Universitetin Amerikan në Kosovë.

Prania ndërkombëtare në Kosovë - duhet të krijoj kushte dhe të siguroj zbatim të plotë të dispozitave të Propozimit Gjithëpërfshirës për Statusin në tërë territorin e Kosovës, dhe menjëherë të ndërmarrë masat e mëposhtme:

- Të emëroj administratorë ndërkombëtarë komunal në komunat serbe sa më parë të jetë e mundur për të shmangur çrregullimin ligjor dhe të qeverisjes të krijuar pas

¹⁷ Është pjesë e programit të financuar nga BE për rritjen e kapaciteteve të institucioneve të Kosovës për adaptimin e standardeve dhe politikave të BE-së.

- zgjedhjeve komunale të organizuar nga Beogradi më 11 maj 2008, për përhapjen e konfliktit potencial;
- Urgjentisht të ri themeloj regjimin doganor në kufi dhe të parandaloj kontrabandimin në jug të Kosovës;
 - Të siguroj funksionim adekuat të sistemit policor dhe gjyqësor në pjesën veriore të Kosovës, duke përfshirë vendosjen e EULEX-it;
 - Te mos inkurajoj legjitimitetin e institucioneve “ paralele” në veri dhe t’i izoloj ato;
 - Të nxis Komisionin Evropian, EULEX-in dhe ICO-n të ri konsideroj ndryshimin e lokacionit të stacionit “*TV Arte style*”, dhe ta zhvendos nga Mitrovica në qendër të Kosovës, duke i mbajtur dy studio në Mitrovicë.

Bashkimi Evropian BE- në pajtim me këtë strategji dhe përkushtimin e përgjithshëm për integrimin dhe stabilitetin ne Ballkanin Perëndimor duhet:

- Të përdorë procesin e integrimit në BE me Serbinë për t’u kyçur në mënyrë konstruktive në dialog për çështjet e interesit të përbashkët në Kosovë;
- Të forcoj komponentën politike të Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian të PCN/PSBE në mënyrë që të ndihmoj në plotësimin e kriterëve politike të integrimit në BE në Kosovë dhe në kontekst rajonal.

Grupi Drejtues Ndërkombëtarë (GDN) dhe NATO duhet të marrin rol aktiv në rirforcimin e vazhdueshëm të të gjitha palëve ndërkombëtare dhe rajonale se asnjë ndryshim i kufijve të Kosovës nuk do të materializohet në politikë realiste dhe

- Të garantoj ne mënyrë praktike integritetin territorial të Kosovës.